

VENDIM
Nr.490, datë 23.7.2004

PËR KUFIZIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË VITIT 2004

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 31 e 32, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003, “Për buxhetin e shtetit, të vitit 2004”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha shpenzimet operative administrative, me përjashtim të shpenzimeve të personelit, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, të institucioneve buxhetore, nuk autorizohen të përdoren deri në masën 10 për qind, për periudhën e mbetur të vitit 2004. Degët e thesarit në rrethe nuk do të kryejnë asnjë veprim pa realizuar më parë bllokimin e kësaj shume për çdo institucion buxhetor.

2. Subvencionet e papërdorura, të parashikuara për 6-mujorin e parë të vitit 2004, të mos mbarten për periudhën në vijim.

3. Të gjitha kursimet nga prokurimet të mos rishpërndahen, përveç rasteve që miraton Kryeministri, me propozimin e ministrit të Financave.

4. Fondet për kosto lokale dhe TVSh për projektet me financim të huaj përdoren vetëm për të njëjtin qëllim në ministri dhe institucione të tjera, me përjashtim të rasteve specifike, të cilat përcaktohen nga Ministri i Financave.

5. Të gjitha fondet e paprokuruar të institucioneve buxhetore, për blerje automjesh dhe pajisje zyrash, me përjashtim të kompjuterave, të mos përdoren.

6. Kufizimet sipas pikave 1, 3 e 5 të zbatohen edhe për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

7. Përfshihen nga kufizimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi institucionet e pavarura nga Këshilli i Ministrave, sipas tabelës 1/1, që i bashkëlidhet ligjit nr.9165, datë 23.12.2003, “Për buxhetin e shtetit, të vitit 2004”.

8. Vlerësimi i shpenzimeve mbi këto kritere do të shërbejë si bazë për llogaritjen e tyre në buxhetin e vitit 2005.

9. Ngarkohen të gjithë titullarët e ministrive dhe të institucioneve buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINI STRI
Fatos Nano